



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS FUSHË KOSOVE

Numri i lëndës: 2021:041002

Datë: 23.01.2024

Numri i dokumentit: 05227374

C.nr.806/21

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - DEGA NË FUSHË KOSOVË, përmes gjyqtarit Freskim Musliu, në çështjen juridike kontestimore të paditësit Ali Cakaj nga Fushë Kosova, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit avokati Fitim Gashi nga Prishtina, rr. “Fehmi Agani”, hyrja 25/4, ndaj të paditurës Komuna e Fushë Kosovës - Drejtoria për Shëndetësi, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Hasime Qyqalla, juriste tek e paditura, me objekt kontesti pagesa e shpërblimit jubilar, jashtë seancës, me datë 23.01.2024 mori këtë:

**AKTGJYKIM**

Për shkak të padëgjueshmërisë

I. APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit Ali Cakaj nga Fushë Kosova dhe DETYROHET e paditura Komuna e Fushë Kosovës – Drejtoria për Shëndetësi, që paditësit në emër të kompensimit të shpërblimit jubilar për 20 vite përvojë pune, t’ia paguajë në vlerë të dy pagave bazë shumë prej 786 euro, me kamatë ligjore prej 8%, e cila do të llogaritet nga data 03.03.2021 kur është parashtruar padia, e deri në pagesën definitive, dhe atë në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

II. DETYROHET e paditura që paditësit t’ia kompensojë shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë të përgjithshme prej 124.00 €, në afat prej 7 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

**Arsyetimi**

Paditësi, përmes të autorizuarit të tij, me datë 03.03.2021, ka parashtruar padi kundër të paditurës Komuna e Fushë Kosovës – Drejtoria për Shëndetësi, për pagesën e shpërblimit jubilar, me kamatë ligjore. Paditësi padinë e tij e ka ndryshuar në aspektin objektiv me parashtrësën e datës 22.12.2023.

Në padi dhe në parashtrësën për ndryshimin e padisë ka theksuar se është i punësuar në QKMF “Dr. Fatmir Krasniqi” në Fushë Kosovë, dhe ka 22 vite përvojë pune. Më tutje ka theksuar se paditësi sipas listës së pagave pagën bazë e ka 393 euro, dhe atij i takon kompensimi në emër të shpërblimit jubilar në vlerë të dy pagave nga 393 euro, e gjithsej shuma prej 786 euro. Shpenzimet i ka kërkuar, dhe atë 104 euro për përpilimin e padisë, 104 euro për përpilimin e parashtrësës për ndryshimin e padisë dhe 20 euro për taksë gjyqësore.

E paditura, me datë 24.03.2023 e ka pranuar aktvendimin për përgjigje në padi, së bashku me padinë dhe provat, dhe me datë 26.12.2023 e ka pranuar parashtresën për ndryshimin e padisë të datës 22.12.2023, por fare nuk ka paraqitur përgjigje në padi.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, parashtresës për ndryshimin e padisë si dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 8, lidhur me nenin 150 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) gjeti se plotësohen të gjitha kushtet për marrjen e aktgjykimit për shkak të padëgjueshmërisë, andaj, pa caktuar seancë fare, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Neni 150.1 i LPK-së, parasheh se *“Në qoftë se i padituri, brenda afatit të përcaktuar me këtë ligj, nuk e paraqet në gjykatë përgjigjen në padi, gjykata jep aktgjykim me të cilin e aprovon kërkesëpadinë (aktgjykim për shkak të mosbindjes) po që se janë plotësuar këto kushte: a) po që se të paditurit i është dorëzuar rregullisht padia dhe thirrja për dhënien e përgjegjës në padi; b) po që se themelësia e kërkesëpadisë del nga faktet e treguara në padi; c) po që se faktet mbi të cilat mbështetet kërkesëpadia nuk janë në kundërshtim me provat që i ka propozuar vet paditësi apo me faktet e ditura botërisht”*.

Sa i përket kushtit të parë të cekur më lart, gjykata nga shkresat e lëndës, konstaton se e paditura e ka pranuar me rregull edhe aktvendimin për përgjigje në padi, bashkë me padinë dhe provat tjera, edhe parashtresën për ndryshimin e padisë, dhe ka qenë e njoftuar me aktvendimin për përgjigje në padi, që nëse e paditura nuk përgjigjet në padi dhe gjykata vlerëson se plotësohen kushtet ligjore, do të marrë aktgjykim për shkak të padëgjueshmërisë, por, megjithatë, e paditura nuk është përgjigjur në padi.

Sa i përket gjendjes faktike, nga Kontrata e punës për kohë të pacaktuar, e datës 15.03.2013, me nr. të protokollit 122, gjykata vërtetoi faktin se paditësi ka lidhur kontratë pune me të paditurën, përkatësisht me QKMF “Dr. Fatmir Krasniqi” në Fushë Kosovë, për pozitën e punës drejtues i automjetit – autoambulancës.

Nga lista e pagave e datës 27.08.2020 gjykata vërtetoi faktin se paditësi pagën bazë e ka në vlerë prej 393 euro.

Nga vërtetimi mbi përvojën e punës, i lëshuar nga QKMF “Dr. Fatmir Krasniqi”, i datës 08.12.2023, me nr. protokollit 1342, gjykata vërtetoi faktin se paditësi ka qenë i punësuar tek e paditura deri me datë 23.05.2023, dhe përvoja e tij e punës deri me këtë datë është 23 vite, e që nënkupton se viti jubilar prej 20 viteve është arritur në vitin 2020.

Në rastin konkret lidhur me kushtin e dytë që ka të bëjë me themelësinë e kërkesëpadisë, gjykata zbatoi Kontratën Kolektive Sektoriale, e lidhur me datë 11.06.2018, dhe e nënshkruar nga Organizata e të punësuarve (Federata e Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës) si dhe Qeveria e Republikës së Kosovës (Ministria e Shëndetësisë) (në vijim KKS), e cila ka qenë në fuqi nga data 11.06.2018, e deri më 10.06.2021, dhe kështu, në ndërlidhje me gjendjen faktike të vërtetuar si më lart, vlerëson se kërkesëpadia e paditësit është e themeltë.

Me nenin 4, paragrafi 1, pika 1. të KKS-së, parashihet që *”KKS-ja gjen zbatim në rregullimin e raporteve juridike për të gjithë të punësuarit nëpër institucione shëndetësore, duke përfshirë tri nivelet e sistemit shëndetësor, atë parësor, dytësor dhe tretësor”*, dhe paragrafi 2 *“Fushë zbatimi i KKS-së ushtron efekt tek punëtorët shëndetësor dhe administrativ në institucione shëndetësore”*.

Gjithashtu, me nenin 17 paragrafi 3 të KKS-së parashihet se *“punëtorët shëndetësor, në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i fundit në vlerë [...] për 20 vjet të përvojës në punë në institucione shëndetësore, të punëdhënësi i fundit, në vlerë të dy pagave mujore të tij”*. Kurse, paragrafi 4 i po të njëjtit nen përcakton se *“Punëdhënësi i fundit është ai që i paguan shpërblimet jubilarë. Shpërblimi jubilar, paguhet në afat prej një muaji, pas plotësimit të kushteve nga ky paragraf”*.

Në rastin në fjalë gjykata gjeti se e paditura ka pasur për detyrim t’ia paguajë paditësit kompensimin për shpërblim jubilar. Kjo për faktin se ky detyrim është paraparë me nenin 17, paragrafi 3 i KKS-së.

Lidhur me lartësinë e kërkesëpadisë së paditësit, gjykata u bazua në listën e pagave në emër të paditësit, si dhe në vërtetimin mbi përvojën e punës së paditësit, ku nga listat e pagave u konstatua se i njëjtit pagën bazë e kanë në lartësi prej 393 eurove, ndërsa nga vërtetimi i përvojës së punës u vërtetua se i njëjtit ka mbi 20 vite përvojë pune, dhe kështu atij i takon kompensimi në vlerë të dy pagave bazë nga 393 euro, përkatësisht shuma prej 786 euro, ashtu siç është vendosur në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Rrjedhimisht, nga gjendja faktike e lartcekur, e vërtetuar me provat e propozuara nga paditësi, gjykata konstaton se plotësohet edhe kushti i tretë për marrjen e këtij lloji të aktgjykimit, pasi që faktet mbi të cilat mbështetet kërkesëpadia nuk janë në kundërshtim me provat që i ka propozuar vet paditësi apo me faktet e ditura botërisht, por përkundrazi, janë në përputhje të plotë me provat e propozuara nga paditësi.

Lartësia e kamatës prej 8%, është përcaktuar në bazë të nenit 382 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD) dhe e njëjta do të llogaritet në shumën e aprovuar nga dita e parashtrimit të padisë e deri në pagesën definitive.

Vendimin që pala e paditur t’i bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në nenin 452 të LPK-së. Lartësia e shpenzimeve të procedurës të aprovuara në shumën prej 124.00 €, i referohet shpenzimeve për përpilimin e padisë në shumë prej 104 euro, duke u bazuar në Tarifën e Odës së Avokatëve të Kosovës, dhe 20 euro në emër të taksës gjyqësore. Ndërsa, gjykata nuk e detyroi të paditurën që paditësit t’ia paguajë edhe shumën prej 104 euro në emër të parashtresës për ndryshimin objektiv të padisë, pasi që paditësi me fajin e tij nuk e ka paraqitur padinë të rregulluar që nga fillimi.

Nga se u tha më lart, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – DEGA NË FUSHË KOSOVË  
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil  
C.nr.806/21, datë 23.01.2024

Gjyqtari  
Freskim Musliu

---

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.